

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje të trupit gjykues, gjyqtarëve Arben Hoti- kryetar, Suzana Çerkini dhe Beqir Kalludra– anëtarë të Trupit Gjykues, me sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurve Q.H dhe F.H, të akuzuar për veprën penale në bashkëkryerje Kontrabandim me migrantë nga neni 170/2 lidh me par 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti Për Krime të Rënda, PPI.nr. 539/2015 e dt. 29.09.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës dt.19.01.2017, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit – Besa Limani, e pandehura Q.H, me mbrojtësit sipas autorizimit av N.H dhe A.G, i pandehuri F.H, me mbrojtësin av N.K, sipas autorizimit, pas seancës për këshillim dhe votim me dt.23.01.2017, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- I.** **Q.H** e bija e M dhe S e vajzërisë K, e lindur me datën *data e lindjes* në Gj, tani jeton në fshatin Ll, Komuna M, ka të kryer shkollën fillore, e martuar, nënë e tre fëmijëve, amvise, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë.

ËSHTË FAJTORE

Sepse: e pandehura Q.H, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt apo të tërthortë të dobisë financiare, ka siguruar, poseduar dhe furnizuar dokumente të rrejshme të udhëtimit me qëllim të mundësimit të kontrabandimit me migrant, në atë mënyrë që me dt 03.07.2015 rreth orës 00:30 minuta, në Pikë kalimin kufitar në Merdare, me qëllim të kontrabandimit të dëmtuarve –fëmijëve D.Z (2004), dhe D.Z (2010), si dhe të dëmtuarit L.Z, pasi paraprakisht janë marr vesh me të dëshmitarin-të dëmtuarin L.Z, që të pandehurës Q t’ia paguaj shumë prej 1700 €, ndërsa Q me këtë rast do të shfrytëzonte dokumentet e fëmijëve të saj R.H (2009) dhe M.H (2011) të cilët kishin pasaporta kroate dhe mund të udhëtojnë pa viza, ndërsa sipas marrëveshjes paraprake me të pandehurën Q.H, I pandehuri F.H me veturën e tipit “BMW ..” ngjyrë të zezë metalike, me targa të regjistrimit *targa te regjistrimit*, pronë e të pandehurit F, në të cilën ishte edhe e pandehura Q.H, I kishte transportuar nga M të dëmtuarin-dëshmitarin L.Z, dhe fëmijët D dhe D.Z, deri në Merdare, por janë ndaluar nga Policia kufitare e asaj pike, dhe iu janë konfiskuar dokumentet.

- Me këtë e pandehura Q.H kryer veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170 par.2 të KPRK-së.

- II.** **F.H** i biri i G dhe R e vajzërisë Sh, i lindur me datën *data e lindjes*, në fshatin S, Komuna e M, ku edhe jetonë, ka të kryer shkollën e mesme, hotelier, i martuar,

babë i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal *numer personal*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse: e pandehura Q.H, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt apo të tërthortë të dobisë financiare, ka siguruar, poseduar dhe furnizuar dokumente të rrejshme të udhëtimit me qëllim të mundësimit të kontrabandimit me migrant, në atë mënyrë që me dt 03.07.2015 rreth orës 00:30 minuta, në Pikë kalimin kufitar në Merdare, me qëllim të kontrabandimit të dëmtuarve –fëmijëve D.Z (2004), dhe D.Z (2010), si dhe të dëmtuarit L.Z, pasi paraprakisht janë marr vesh me të dëshmitarin-të dëmtuarin L.Z, që të pandehurës Q t’ia paguaj shumën prej 1700 €, ndërsa Q me këtë rast do të shfrytëzonte dokumentet e fëmijëve të saj R.H (2009) dhe M.H (2011) të cilët kishin pasaporta kroate dhe mund të udhëtojnë pa viza, ndërsa sipas marrëveshjes paraprake me të pandehurën Q.H, I pandehuri F.H me veturën e tipit “BMW ...” ngjyrë të zezë metalike, me targa të regjistrimit *targa te regjisrtimit*, pronë e të pandehurit F, në të cilën ishte edhe e pandehura Q.H, I kishte transportuar nga M të dëmtuarin-dëshmitarin L.Z, dhe fëmijët D dhe D.Z, deri në Merdare, por janë ndaluar nga Policia kufitare e asaj pike, dhe iu janë konfiskuar dokumentet.

- Me këtë i pandehuri F.H kishte për të kryer veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 6,35,38,39,60,64,73,75 të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPRK –së,

GJYKON DËNIM ME BURGIM

Të pandehurën **Q.H** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1(një), vit e një (1) muaj**, në të cilin dënim do t’i llogaritet koha e qëndrimit në arrest shtëpiak prej datës **03.07.2015 deri me dt. 02.08.2016**, dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilin dënim është e obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të zëvendësoj dënimin në gjobë, ashtu që një ditë burgimi do të llogaritet me 20 euro gjobë të shqiptuar.

Obligohet e pandehura që të paguajnë shpenzimet e procedure penale, dhe atë paushallin gjyqësorë në shumën prej 100 euro, të gjitha në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës lidhur me të pandehurin F.H bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

I dëmtuari L.Z nga fshati Lla Komuna M, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka paraqitur aktakuzën PPI.nr 539/2015 me dt 29.09.2015, kundër të pandehurve Q.H dhe F.H, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Kontrabandim me migrantë nga neni 170/2 lidh me par. 1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimet gjyqësore, ku të pandehurve i është lexuar aktakuza, ndërsa kryetari i trupit gjykues- gjyqtari pasi u bind se të pandehurit e kanë kuptuar përmbajtjen e akuzës, të njëjtëve i dha mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohen të pafajshëm.

E pandehura Q.H, është deklaruar e pafajshme për akuzën e cila i vihet në barrë.

I pandehuri F.H, është deklaruar i pafajshëm për akuzën e cila i vihet në barrë.

Shqyrtimi gjyqësorë dhe deklaratimet e palëve

Shqyrtimi gjyqësorë ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve ku prokurori i shtetit dhe palët tjera në procedurë, kanë përmbledhur provat që mbështesin rastin dhe kërkesat e tyre,¹ ndërsa më pastaj në procedurën e provave shqyrtimi ka vazhduar me dëshminë e të dëmtuarve - dëshmitarëve.

Dëshmitari Sh.Z, në dëshminë e tij mes tjerash ka deklaruar se: ka dhënë deklaratë në Prokurori dhe qëndron pranë saj, se L dhe A.Z i ka djem, ndërsa D dhe D janë fëmijët e djalit të tij A, ku i njëjti gjendet në F, ndërsa L në Gj. I njëjti ka dëshmuar se L në Gj ka shkuar për afërsisht rreth një viti e një muaj më parë bashkë me fëmijët D e D, se të njëjtit kanë shkuar pa dokumente të rregullta, duke i kaluar kufijtë.

Ky dëshmitarë ka shtuar se të njëjtit kanë tentuar të dalin edhe më herët por nuk kanë pasur sukses, kjo kishte ndodhur në Korrik të vitit 2015, dhe se L nuk kishte kërkuar para nga dëshmitari Sh.Z, Sipas dëshmitarit arsyeja pse L me fëmijët kanë dashur me shkuar në F ishte se A ishte atje me gruan e tij, pasi që kishin shkuar atje më herët për shërimin e djalit të tyre, konkretisht nipit të dëshmitarit, i cili fatkeqësisht kishte ndërruar jetë nga sëmundja e leukemisë, dhe se pas tentimit në mënyrë ligjore ti dërgojnë fëmijët te prindërit e tyre, pasi që nuk kishin sukses, atëherë kanë provuar që L ti dërgojë fëmijët në F në çfarëdo mënyre.

Dëshmitari O.I në dëshminë e tij mes tjerash ka deklaruar se: Se ditën kritike kishte qenë në vendkalimin kufitare në Merdare, duke transportuar rërë me kamion, dhe se aty kishte qenë me disa shokë si I.Z, Rr, V etj. Atë ditë sipas dëshmitarit ishin duke pritur pranë kamionëve që të kalojnë në Kosovë, se kishte parë që kanë ardhur dy femra me një fëmijë, prej anës së Kosovës brenda në kufirin e Serbisë rreth 100 metra, të cilat kishin qenë duke kaluar në këmbë, se njëra prej tyre ishte bionde tjetra nuk i kujtohej, rreth moshës 30 vjeçare, se ishte e dobët, se ato fillimisht ishin ulur në një beton, kishin qëndruar disa minuta duke komunikuar mes vete dhe se ata vetëm i kishin shikuar. Më pas dëshmitari ka shtuar se në atë moment kishin ardhur disa Serb me disa taxi, rreth 4-5 vetura, se ato vetura i ishin afruar atyre dy femrave dhe fëmijës, se kishin filluar të komunikonin por nuk e dinte se çfarë kanë komunikuar, ngase dëshmitari ishte në një distancë prej 20 metrave.

Fillimisht kishin komunikuar me një person në gjuhën Serbe, pastaj ishte afruar edhe një person tjetër kishte filluar komunikimin, në një moment fëmija kishte filluar të qaj, se u mundonin të pajtonin fëmijën por se nuk kishin mundur, pastaj të njëjtat e kanë kapur fëmijën dhe kishin ikur mbrapa një barake në terr (errësirë), dhe se kur e kishin futur atje, fëmijës menjëherë i ishte ndalur bërtitja, dhe dëshmitari supozon se ja kanë mbyllur gojën. Pastaj

¹ Shih fjala hyrëse e paleve.

sipas këtij dëshmitari kishin filluar të vinin disa djem të rinjë, fillimisht 2 persona, pastaj edhe 3 persona, për të cilët dëshmitari kishte përshtypje që ishin të përgatitur për të shkuar tutje, sepse të njëjtit ishin në territorin e Serbisë për afërsisht 100 metra brenda tij, dhe se ishte periudha ku shumë Kosovarë kanë dalë jashtë shtetit, dhe se ajo gruaja biondina u kishte shpërndarë disa letërnjoftime, disa vërtetime, dhe pas shpërndarjes së dokumenteve grupi i të rinjve ishin vendosur në vetura, pastaj dëshmitari kishte biseduar me shoqërinë e tij, duke menduar të lajmërojë rastin sepse i ishte dukur diçka e dyshimtë ngase i kishte bërë përshtypje largimi i asaj gruas, largimi i fëmijës, qarja e fëmijës, dhe se heshtja e fëmijës i ishte dukur e dyshimtë duke menduar se ishte bërë në mënyrë të dhunshme. Sipas dëshmitarit në momentin kur ajo biondina ishte duke biseduar me taksistin, dëshmitari ishte nisur për të lajmëruar rastin në portën e Policëve të Kosovës.

Sipas këtij dëshmitari derisa femra bionde apo (biondina) siç i referohet dëshmitari, ishte duke biseduar ende me taksistin, dëshmitari i ka treguar me gisht se për cilën grua po e tregonte rastin, pastaj i njëjti ishte kthyer te puna e vet. Ky dëshmitarë në seancë gjyqësore e ka identifikuar të pandehurën Q.H.

Dëshmitari I.Z, në dëshminë e tij mes tjerash ka deklaruar se: natën kritike ishte te kufiri duke pritur për me hy në Kosovë, ishte me kamion, dhe në një beton kishin qenë të ulur dy persona Serb, dhe se edhe ata ishin ulur aty dhe të njëjtit, pra Serbët e lartcekur i kishin pasur afër rreth 1 metër. Në një moment sipas këtij dëshmitari kishin ardhur dy femra dhe një fëmijë i vogël dhe një djalë në moshën 15-16 vjeç, të njëjtin kishin shkuar aty dhe ishin përshëndetur me Serbët, u ulën me ta aty dhe filluan bisedën, se pas një kohe kishin vërtetuar se ata ishin taksistë. Se përshkrimin e atyre dy femrave e bëri duke theksuar se njëra ishte më në moshë, njëra më e re, se femra që ishte më në moshë kishte pasur një fëmijë për dore afër 3-4 vjet, se nuk mund ta identifikojë saktë nga pamja, por meqenëse e kishte parë për afër në sallën e Gjykimit theksojë se mund të them se ishte ajo (duke aluduar në të akuzuarën Q).

Dëshmitari- i dëmtuari L.Z, në dëshminë e tij mes tjerash ka deklaruar: Sa i përket ditës kritike i njëjti ishte nisur për t'i dërguar fëmijët e vëllaut në F, se vëllau i tij me gruan dhe fëmijën e vogël ishin në F, sepse fëmija i vëllaut të tij ishte i sëmur nga leukemia dhe se atje ishte për shërim, se fëmijët tjerë të vëllaut të tij kishin mbetur në Kosovë, se qëllimi i tij ishte ti dërgonin fëmijët tek prindërit e tyre, që të bashkoheshin. Ky dëshmitarë ka dëshmuar se fëmijët kishin vetëm certifikata të lindjes, ndërsa dëshmitari kishte vetëm letërnjoftim, dhe prej Qendrës Sociale një dokument që ishte mbikëqyrës i fëmijëve.

Dëshmitari ka dëshmuar se ditën kritike tek kufiri ishte nisur bashkë me shokun e tij F pasi që i njëjti nuk kishte veturë të tij, ku se bashku me ta ishin dhe fëmijët D e D.Z, dhe se me Q ishin takuar në kufi, ndërsa dëshmitari ishte munduar të kalojë vetë kufirin por Policia e Kosovës i kishte thënë se pa qenë ndonjëri prej prindërve nuk mundën me kaluar kufirin.

Sa i përket të pandehurës Q.H dëshmitari ka dëshmuar se të pandehurën e kishte pyetur se si kanë dalur njerëzit e tjerë, dhe se kishin biseduar se si mundet me e i ndihmuar, ndërsa Q i kishte thënë se këqyrim nëse mundemi me të ndihmuar rrugës, por nuk kishin biseduar për punën e çmimit.²

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësorë.

- Raporti i rreshterit i Stacionit Policor në Podujevë- M.V
- Raporti plotësues i dt 13.10.2015
- Raporti ligjore i PTK "Vala" prej datës 01.06.2015 deri me dt 03.07.2015
- Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjëseneve
- Janë lexuar SMS-sat nga Masat e Fshehta Teknike të Vëzhgimit dhe Hetimit

² Shih dëshmia e dëshmitarit L. Z procesverbali I dt.22.12.2016 faqe 6-9

- Raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikës, dhe raporti plotësues i dt 07.09.2015
- Prova materiale dokumentet e të pandehurës Q.H- letërnjoftimi i Kosovës ID- *numri i ID*, patent shoferi Kroat me numër *numri i patentes*
- Dokumentet personale të fëmijëve – pasaporta Kroate e R.H me numër *numri pasaportes*, karta e identifikimit e R.H me numër *numri identifikimit*
- Karta e identifikimit e M.H me numër *numri kartes*
- Raporti i policit hetues i dt 03.07.2015
- Është bërë shikimi i foto dokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndës

Mbrojtja e të pandehurve

Të pandehurit Q.H dhe F.H, në shqyrtim gjyqësorë kanë deklaruar se do të shfrytëzojnë të drejtën e garantuar me ligj për tu mbrojtur në heshtje.

Fjala përfundimtar e palëve

Prokurorja e shtetit Besa Limani, në fjalën e saj përfundimtare ka bërë rikualifikimin e veprës penale Kontrabanimi me migrante nga neni 170 par.2 lidhur me par 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, sa i përket paragrafit, dhe e njëjta të pandehurit i ka akuzuar sipas nenit 170 par.1 lidhur me nenin 31, dhe ,ë pas ka shtuar se është vërtetuar gjendja faktike se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkohen, dhe njëherit prokurorja e shtetit i ka propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpall fajtorë dhe ti dënoj sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh gjykata edhe rrethanat e parapara sipas ligjit.³

Mbrojtësi i të pandehurës Q.H- av N.H, fjalën përfundimtare e ka përgatitur me shkrim, duke theksuar mes tjerash se: gjatë rrjedhjes së shqyrtimit gjyqësorë Prokuroria nuk ka arritur ta mbështes pretendimin e vet me prova konkrete se e mbrojtura e tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj i ka propozuar Gjykatës që të merr Aktgjykim shfajësues në mungesë të provave.

E pandehura Q.H, në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit të saj, duke shtuar se ende konsideron se ndihet e pafajshme për veprën që i vihet në barrë.

Mbrojtësi i të pandehurit F.H- av N.K në mes tjerash në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: *edhe nga seancat e mbajtura në Gjykatës është vërtetuar se i mbrojturi i tij është i pafajshëm, kurse pas rikualifikimit të veprës penale nga ana e Prokurorisë shihet qartë se i njëjti është i pafajshëm, dhe pasi asnjë nga provat e propozuara nga organi ndjekës nuk e vërteton akuzën e ngritur në drejtim të mbrojturit të tij, e gjithë kjo për arsye se i mbrojturi i tij as nuk ka prodhuar, as nuk ka furnizuar, as nuk ka siguruar e as që ka pasur në posedim dokumente të rrejshme, të udhëtimit apo të mundësojë dikujt kontrabandim me migrantë, dhe ka kërkuar nga Gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të merret aktgjykim lirues.*

I pandehuri F.H, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: *se e përkrah fjalën e mbrojtësit të tij, dhe se nuk ka çfarë të shtojë tjetër.*

Gjetjet e Gjykatës.

Gjykata pas procedurës së provave, analizimit të tyre secilës veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, e ka vërtetuar gjendjen e fakteve si në dispozitiv e parë të këtij aktgjykimi, sa i përket të pandehurës Q.H, dhe këtë gjendje të fakteve e ka vërtetuar në bazë të dëshmime të

³ Shih fjala përfundimtare e prokurores së shtetit

dëshmitarëve, dhe provave materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësorë, duke nxjerrë përfundime se faktet konkrete janë provuar.

E pandehura Q.H është shpallur fajtores për veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 172 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e cila veprë penale përcakton; *kushdo që me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore, prodhon furnizon, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit, me qëllim të mundësimit të kontrabandimit me migrantë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në (5) vjet.* Pra kjo është formë e veçantë e veprës penale Kontrabandimi me Migrant që si veprim të kryerjes e ka edhe prodhimin, prokurimin, sigurimin ose posedimin e dokumentit të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimit të marrjes me trafikim me migrantë. Sipas këtij paragrafi të gjitha këto lloje të veprimeve ndërmerren me qëllim për të fituar drejtpërdrejtë ose tërthorazi dobi pasurore ose financiare.

Nga dëshmia e dëshmitarit Sh.Z, Gjykata ka vërtetuar faktin se djali i tij A së bashku me gruan e tij kishin shkuar në F me qëllim të shërimit të fëmijës së tyre i cili kishte qenë i sëmur nga leukemia, por që fatkeqësisht kishte vdekur, e që ndërkohë fëmijët e tjerë të këtij çifti D dhe D kishin mbetur në Kosovë, konkretisht në shtëpinë e dëshmitarit i cili është edhe gjyshi i tyre. Nga dëshmia e këtij dëshmitari po ashtu Gjykata ka vërtetuar faktin se A pra baba i D dhe D kishte kontaktuar edhe me dëshmitarin me qëllim të shikojnë mundësin se si të dërgohen D dhe D në F. Nga dëshmia e këtij dëshmitari po ashtu është vërtetuar fakti se L djali tjetër i dëshmitarit kishte tentuar në një rast që së bashku me fëmijët D dhe D të kalojnë kufirin të dalin në perëndim, mirëpo herën e parë nuk kishin pasur sukses, ndërsa herën e dytë kanë kaluar. Dëshmitari është ballafaquar në shqyrtim gjyqësorë me deklaratën e dhënë në Prokurori në të cilën ka deklaruar se për këtë shërbim ka qenë dashur të paguajnë të holla, ndërsa në shqyrtim gjyqësorë këtë fakt e ka mohuar, mirëpo nuk ka dhënë shpjegime se pse atëherë ka deklaruar ndryshe, pra nuk ka mundur ti sqarojë mos përputhjet mes deklaratave. Nga dëshmia e dëshmitarit L.Z, Gjykata po ashtu e ka vërtetuar faktin se ky dëshmitarë kishte pasur për qëllim që fëmijët e vëllaut të tij A ti dërgojë në F, edhe pse të njëjtit nuk kishin dokumentacion për udhëtim e as viza me qëllim të bashkimit me familje – prindërit e tyre, krejt kjo në rrethana të përshkruara si nga dëshmitari Sh.Z.

Nga deklaratat e dëshmitarëve O.I, dhe I.Z, Gjykata ka vërtetuar faktin se natën kritike e pandehura kishte qenë në pikën kufitare Merdare, se aty ajo kishte kontaktuar me një grup të rinjve dhe me disa vozitës të taksive që kishin ardhur me qëllim të transportimit të këtyre të rinjve. Po ashtu nga dëshmia e këtyre dëshmitarëve gjykata ka vërtetuar faktin se pas denoncimit që kishin bërë këta dy dëshmitarë, e njëjta ishte ndalur në pikën kufitare.

Gjendjen e fakteve Gjykata e ka vërtetuar edhe bazuar në prova materiale si sms – të siguruarat përmes masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, ku rezulton se e pandehura ka kërkuar shumën prej 1700 Euro, për t'i dërguar fëmijët D dhe D në F, dhe për këtë kishin komunikuar me të dëmtuarin L.Z, i cili njëjtë ka deklaruar edhe më deklaratën e tij në polici dhënë më dt.03.07.2015, pavarësisht që në shqyrtim gjyqësorë e ka mohuar një gjë të tillë.

Gjendjen e fakteve gjykata plotësisht e ka vërtetuar në bazë të Raportit të Policisë Hetues M.V i dt.03.07.2015, në bazë të të cilit vërtetohet fakti së e pandehura në kohën e kryerjes së veprës penale, në vendin e ngjarjes me vete ka pasur edhe dy letërnjoftime kroate, dhe një pasaportë po ashtu kroate të fëmijut të saj R.H, me çka vërtetohet fakti se e pandehura përmes dokumenteve tjera që nuk ju përkasin fëmijëve D dhe D.Z, ka marrë për sipër që t'i kontrabandojë në shtetet perëndimore, ndërkohë që këtë të fundit nuk kanë pasur me vete asnjë dokument të udhëtimit, ndërsa në kundërvlerë sipas marrëveshjes paraprake, ka qenë dashur t'i paguajnë të pandehurës shumën prej 1700 euro.

Pra me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor gjykata e ka vërtetuar se e pandehura e ka kryer veprën penale në atë mënyrë që pasi që ka rënë në kontakt me familjen Z të cilët kishin për qëllim që dy fëmijët D dhe D.Z t'i dërgonin në F, ku e pandehura pasi që kishte kontaktuar me familjen Z kishte kërkuar 1700 euro, kjo rrethanë është vërtetuar nga sms e shkëmbyer të siguruar përmes masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, dhe këtë fakt e ka pohuar edhe dëshmitari L.Z në deklaratën e dhënë në polici, e që i njëjti dëshmitarë po ashtu e ka vërtetuar faktin se fëmijët D dhe D nuk kanë pasur asnjë dokument me të cilën do të mund të udhëtonin. Se në veprimet e të pandehurës formësohen të gjitha elementet e figurës së veprës penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, flet edhe fakti i vërtetuar se e njëjta fillimisht kishte siguruar, pra kishte marrë me vete pasaportën kroate e djalit të saj R.H, dhe letërnjoftimin kroat të djalit tjetër të saj M.H për qëllim të kontrabandimit të fëmijëve D dhe D, andaj pikërisht për këto arsye, (edhe pse me kujdes të posaçëm ka analizuar teorinë e mbrojtjes të paraqitur nga mbrojtësit e të pandehurës av.N.H dhe av.A.G.) gjykata ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Ndërsa sa i përket mbrojtjes të pandehurës Q.H dhe mohimit të veprës penale nga ana e saj, Gjykata konsideron se një mohim i tillë nuk ka mbështetje në prova, mirëpo është i orientuar drejt fshehjes së veprimeve inkriminuese me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Ndërsa sa i përket të pandehurit F.H, nuk është vërtetuar me asnjë provë se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar, për faktin se nuk ka prova se i pandehuri ka prodhuar, prokuruar, siguruar ose poseduar me dokumente të rrejshme të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimin të marrjes me trafikim me migrantë, e as që këto lloj të veprimeve t'i ketë ndërmarrë me qëllim për të fituar drejtpërdrejtë ose tërthorazi dobi pasurore ose financiare, andaj në mungesë të këtyre elementeve në veprimet e këtij të pandehuri, nuk formësohen elementet e veprës penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170 par.2 lidhur dhe nenin 31 të KPRK-së, ku pas rikualifikimit të veprës penale nga ana e prokurores së shtetit edhe dispozitivi i akuzës nuk mbanë elemente inkriminuese për këtë të pandehur, përveç asaj se nga dispozitivi i akuzës prokuroria ka pretenduar se i pandehuri F.H këtë vepër e ka kryer në bashkë kryerje më të pandehurën Q pasi që i kishte dërguar më veturën e tij në pikën kufitare në Merdare, ndërkohë që me asnjë provë nuk është vërtetuar kontributi i këtij të bashkakuzuari në prodhimin, prokurimin, sigurimin ose nëse i njëjti ka poseduar dokumente të rrejshme të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimin të marrjes me trafikim me migrantë, ku këto elemente që përmban kjo vepër paraqet inkriminimin në një fazë të hershme të kryerjes së kësaj veprë.

Vendimi mbi dënimin

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin Gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësinë e dënimit, ku me këtë rast si rrethana lehtësuese gjykata për të pandehurin ka marrë parasysh faktin se; nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar më parë për vepra penale, rrethanat e saj familjare, e njëjta është e martuar dhe nënë e dy fëmijëve, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurës, dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj veprë penale, duke qenë e bindur se me dënimin si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale, dhe ky dënim të ndikoj te e pandehura që të përmbahet nga përsëritja e veprave penale, po ashtu të arrihet edhe qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventives gjenerale, që dënimi i shqiptuar të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarve për dëmet e shkaktuara nga vepra penale, por edhe të

shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit, dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nen. 454 par.1. të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë në vështrim të nenit 463/2 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 550/15 të dt. 23.01.2017

Sekretarja juridike:
Shqipe Rexhepi

Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.